



Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 2 nën d. nenit 17 paragrafi 1 nën m dhe j) nenit 40 paragrafi 2 nën paragrafi 5, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040, nenit 10 nën pikën 4, dhe 16 pika 7 të Statutit të Komunës, sipas referencës së Ministrisë së Shëndetësisë të dt.30.06.2015, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VII-të të rregullt, të mbajtur më 20 .07.2015, mori këtë:

V E N D I M

Për

Formimin e Komisionit Profesional për korrigjimin dhe harmonizimin e tekstit të projekt-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare-QKMF- Akt Unik për të gjitha institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor të Kosovës-për harmonizimin e tekstit me specifikat që ka QKMF “Nena Terezë” në Komunën e Klinës.

I

Formohet Komisioni profesional për korrigjimin dhe harmonizimin e tekstit të Projekt-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare –Akt Unik ky për të gjitha institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor të Kosovës, me specifikat që dallon QKMF “Nëna Terezë” në Komunën e Klinës, nga komunat tjera.

II

Komisioni profesional ka këtë përbërje:

- 1.Dr.Ali Ahmetxhekaj
- 2.Qamile Qitaku
- 3.Dr.Filloreta Berisha
- 4.Dr.Hekuran Sejdiu
- 5.Xhemajil Raci-jurist

Çdo ndryshim dhe plotësim që behët nga teksti i Statutit të QKMF-si Akt Unik, me specifikat e Komunës së Klinës, kërkohet që të jetë në harmoni me Ligjin Nr.04/L-125 dhe me Udhëzimin Administrativ 02/2015 dhe të miratohet nga Ministria e Shëndetësisë.

III

Vendimi është i plotfuqishëm me miratimin nga Kuvendi i Komunës dhe 15 ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal konform nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

IV

Me këtë vendim njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Shërbimi për punë të Kuvendit, anëtarët e Komisionit, Zyra Ligjore,Zyra për Informim dhe Arkivi i Komunës së Klinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr 06-4413 / /2015
Klinë, më 20.07.2015

